



KOMUNIKATË
26.02.2010

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 74.4, 74.5, 77.1 (d), 77.2, 77.3, 77.4 dhe 79.1 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Vendimin e KQZ-së të datës 18.02.2010 për përsëritjen e votimit të Raundit të II-të të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Gjilanit, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 26.02.2010, miratoi rekomandimet e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) në Gjilan për emërimin e anëtarëve dhe Kryesuesve të Këshillave të Vendvotimeve (KVV) për Zgjedhjet e përsëritura të Raundit të II-të për Kryetar të Komunës së Gjilanit që do të mbahen me 14 mars 2010.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka emëruar 762 anëtar të KVV-e, për 127 vendvotime. Regjistri i anëtarëve, anëtarëve rezervë dhe Kryesuesve të Këshillave të Vendvotimeve, i është bashkangjitur vendimit, dhe është pjesë përbërëse e tij.